



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 353 Prot.

Tiranë, më 03.02. 2026

Lënda: Dërgohet për miratim plani i veprimtarisë së DPM për vitin 2026

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Adresa: Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë

Të nderuar,

Në mbështetje të pikës 6, gërma b, të VKM nr. 325 datë 18.05.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, bashkëlidhur Ju përcjellim për miratim Planin e Punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për vitin 2026.

Me konsideratë,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Tiranë, më _____.2026

INFORMACION PËR INSTITUCIONIN

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) është institucioni publik përgjegjës për zhvillimin e metrologjisë në Republikën e Shqipërisë. DPM ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr. 126/2020, datë 15.10.2020, “Për Metrologjinë”, si dhe me aktet nënligjore në fuqi.

Misioni i DPM është mbrojtja e konsumatorëve dhe e interesit të shtetit nga pasojat e rezultateve të pasakta të matjeve, zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit kombëtar të metrologjisë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe nevojat kombëtare, si dhe sigurimi i njohjes ndërkombëtare të rezultateve të matjeve dhe të etaloneve kombëtare. Në këtë kuadër, DPM garanton lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara dhe të produkteve të parapaketuara, në përputhje me kërkesat e konformitetit, si dhe harmonizimin e metodave të matjes dhe kontrollit metrologjik.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik publik, me seli në Tiranë, dhe ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nën varësinë e ministrit përgjegjës për Ekonominë dhe Inovacionin. Institucioni drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka një strukturë organike prej 98 punonjësish, të organizuar në 4 drejtori dhe sektorë shërbimi në rrethe.

Struktura organizative e DPM përfshin Drejtorinë e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore, Drejtorinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të cilat bashkëpunojnë për garantimin e zbatimit të legjislacionit dhe ofrimin e shërbimeve metrologjike cilësore.

DPM ofron shërbime kalibrimi dhe verifikimi të instrumenteve matëse, shërbime autorizimi dhe mbikëqyrjeje të subjekteve që veprojnë në fushën e metrologjisë ligjore, si dhe shërbime në kontrollin sasiar të produkteve të parapaketuara.

Gjurmueshmëria metrologjike e matjeve sigurohet përmes kalibrimit periodik të etaloneve kombëtare në institute metrologjike të njohura ndërkombëtarisht, ndërsa sistemi i menaxhimit të cilësisë zbatohet në përputhje me standardin ISO/IEC 17025:2017 dhe ISO/IEC 17020:2012.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është e angazhuar aktivisht në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe evropian, duke qenë anëtare e organizatave kryesore të metrologjisë: Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore (OIML), Byrosë dhe Konferencës Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIPM/CGPM), Organizatës Evropiane të Instituteve të Metrologjisë (EURAMET), Bashkëpunimit Evropian për Metrologjinë Ligjore (WELMEC), dhe Konfederatën Ndërkombëtare të Matjeve (IMEKO), me synim harmonizimin e praktikave metrologjike dhe forcimin e rolit të Shqipërisë në sistemin ndërkombëtar të matjeve.

Prioritetet kryesore të DPM për vitin 2026

Në mënyrë të përmbledhur prioritetet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për vitin 2026 janë:

1. Përafrimi i legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian, në funksion të Kapitullit 1 – “Lëvizja e Lirë e Mallrave”, përmes rishikimit të Ligjit nr. 126/2020 “Për Metrologjinë” dhe të akteve nënligjore përkatëse.
2. Forcimi i sistemit kombëtar të metrologjisë dhe i kapaciteteve institucionale, duke konsoliduar rolin e DPM-së si autoritet kompetent dhe duke rritur eficiencën e strukturave zbatuese.
3. Akreditimi i DPM për shërbimet e kalibrimit, verifikimit të instrumenteve matëse dhe certifikimit të produkteve të parapaktuara me shenjë konformiteti, respektivisht, në përputhje me standardet ISO/IEC 17025, ISO/IEC 17020 dhe ISO/IEC 17065, si dhe me marrëveshjen ndërkombëtare të njohjes reciproke të rezultateve të matjeve (CIPM MRA).
4. Vendosja në eficiencë dhe akreditimi i laboratorëve të rinj për verifikimin e radarëve të shpejtësisë dhe matjet akustike (nivelein e zhurmave)
5. Rivitalizimi dhe akreditimi i laboratorit të forcës për kalibrimin e makinave të provave të maerialeve të ndërtimit dhe laboratorit të kimisë.
6. Sigurimi i gjurmueshmërisë metrologjike dhe njohjes ndërkombëtare të rezultateve të matjeve, përmes mirëmbajtjes (rikalibrimit) së etaloneve kombëtare, pjesëmarrjes në krahasime ndërlaboratorike dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.
7. Rritja dhe modernizimi i kapaciteteve teknike laboratorike, nëpërmjet investimeve në standarde dhe pajisje matëse, zgjerimit të fushëveprimit të matjeve dhe përmirësimit të kushteve të punës.
8. Rritja e cilësisë së shërbimeve metrologjike dhe ndërgjegjësimit publik, me synim mbrojtjen e konsumatorit, garantimin e konkurrencës së ndershme në treg dhe informimin e palëve të interesuara mbi rolin e metrologjisë në ekonomi.

Në vijim paraqitet plani i detajuar i veprimtarisë së DPM për vitin 2026.

Shënim:

Shkurtimet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimet e mëposhtme.

- DPM – Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
- MEI – Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- DPA – Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
- DML – Drejtoria e Metrologjisë Ligjore
- DMSHI – Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale
- DSCP – Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve
- DBNJ&SH – Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. ____prot.

Tiranë, më _____.2026

PLANI I VEPRIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË
PËR VITIN 2026

MIRATOHET

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

OBJEKTIVAT	MASAT DHE VEPRIMET E MARRA	AFATI	TREGUESIT MONITORUES/STATUSI I REALIZIMIT	NJËSIA PËRGJEGJËSE
Përmirësimi i paketës ligjore në fushën e metrologjisë me qëllim përafrimin me acquis të BE për Kapitullin 1 –	1) <i>Draftimi dhe miratimi i projektvendimit për ndryshimin e VKM nr. 1351 datë 03.10.2008 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike metrologjike të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara” dhe VKM nr. 463 datë 18.07.2012 “Për një shtesë në VKM nr. 1351, datë 3.10.2008 “Për miratimin e</i>		Ngritja e grupit të punës Draftimi i projektvendimit shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë dhe relacionin shoqërues	DPM në bashkëpunim me MEI

<p>Lëvizja e Lirë e Mallrave</p>	<p><i>rregullores për kërkesat teknike metrologjike të instrumenteve matëse ligjërishi të kontrolluara”.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> i. Ngritja e grupit të punës ii. Draftimi i projektvendimit shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë dhe relacionin shoqërues iii. Dërgimi për konsultim ndërinstitucional (MEI, MD dhe MEPJ) iv. Konsultimi publik v. Dërgimi për miratimi në qeveri 	<p>Tremujori parë Tremujori dytë</p> <p>Tremujori tretë</p> <p>Tremujori tretë</p> <p>Tremujori katërt</p>	<p>Projektakti dërgohet në MEI Realizimi i konsultimit publik</p> <p>Projektakti miratohet nga Këshilli i Ministrave</p>	<p>Grup pune ndërinstitucional DPM, MEI dhe ISHMT</p>
<p>2) <i>Rishikimi (amendimi) i Ligjit nr. 126 datë 15.12.2020 “Për metrologjinë”</i></p> <ol style="list-style-type: none"> i. Ngritja e grupit ndërinstitucional të punës ii. Raporti i vlerësimit dhe draftimi i ndryshimeve shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë dhe relacionin shpjegues iii. Konsultimi publik 	<p>Tremujori dytë</p> <p>Tremujori tretë</p> <p>Tremujori katërt</p>	<p>Projektakti i ndryshimit/amendimit të ligjit shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë dhe relacioni shpjegues</p>	<p>Projektakti i ndryshimit/amendimit të ligjit shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë dhe relacioni shpjegues</p>	<p>DPM në bashkëpunim me MEI</p>
<p>3) <i>Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë” përkatësisht:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a) <i>Urdhër i ministrit për miratim tipi</i> b) <i>Udhëzimi i tarifave</i> c) <i>Urdhër i ministri për shenjë dalluese</i> d) <i>Rregullore e brendshme e DPM</i> 	<p>Gjashëmujori i parë</p>	<p>Aktet nënligjore të miratuara</p>	<p>Aktet nënligjore të miratuara</p>	<p>DPM në bashkëpunim me MEI</p>
<p>Mirëmbajtja dhe zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në përputhje me standardin ISO/IEC 17025 dhe</p>	<p>1. Sigurimi i gjurmueshmërisë nëpërmjet rikalibrimit periodik të etaloneve të matjeve, mirëmbajtja e etaloneve kombëtare të fushave përkatëse, trajnimi i stafit të këtyre laboratorëve, si dhe mundësimi i pjesëmarrjes në ndërkrahasime laboratorike.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit</p>	<p>Prokurimi me sukses i shërbimit të rikalibrimit të etaloneve të matjeve të programuara për vitin 2026</p>	<p>DMSHI në DPM</p>

<p>marrëveshjen CIPM MRA, si dhe akreditimi i tre (3) laboratorëve nga një trupë akreditimi e njohur ndërkombëtarisht, nënshkruese e marrëveshjes EA MLA</p>	<p>Rishikimi i dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe (CIPM MRA) bazuar në nevojat e evidentuara gjatë vitit 2025.</p> <p>2. Zgjerimi i Sistemit të Menaxhimit sipas ISO/IEC 17025:2017 dhe përgatitja e laboratorëve të forcës, kimisë dhe volumeve të mëdha për procesin e akreditimit, sipas procedurave përkatëse, për kalibrimin e makinave të provave të materialeve, analizuesve të frymës dhe rezervuarëve.</p> <p>3. Pjesëmarrja e laboratorëve kalibrues në krahasime ndërlaboratorike për:</p> <ol style="list-style-type: none"> kalibrimin e multimetrave për madhësitë elektrike AC/DC tension, rrymë dhe rezistencë kalibrimin e termorezistencave (PRT) në diapazonin matës -80 °C deri në 280 °C. kalibrimin i instrumentave matës të presionit (1 bar deri në 700 bar) kalibrimin e enëve të qelqit (5 ml deri në 20000 ml) kalibrimin e depozitave/rezervuarëve (1 m³ deri në 25 000 m³) kalibrimin e gramarëve (1 mg deri në 20 kg) <p>4. Planifikimi, kryerja dhe dokumentimi i auditimeve/kontrolleve të brendshme të Sistemit të Menaxhimit sipas programit vjetor të auditimeve në bashkëpunim me ekipet</p>	<p>Gjatë gjithë vitit</p> <p>Gjashëmujori i parë</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit, sipas programit vjetor të auditimeve</p>	<p>Dokumentacioni i rishikuar miratuar nga strukturat përkatëse sipas përgjegjësi</p> <p>Rishikimi i dokumentacionit teknik të SMC-së në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017, përcaktimi i skopit të akreditimit dhe identifikimi i ndërkrahasimeve laboratorike</p> <p>Evidentimi i krahasimeve ndërlaboratorike në proces apo regjistrimi i tyre sipas fushave përkatëse në ILC të reja. Protokollet teknike Raportet e krahasimeve ndërlaboratorike</p> <p>Programet dhe raportet e auditimeve të brendshme të cilësisë</p>	<p>DSCP bashkëpunim DMSHI</p> <p>DMSHI bashkëpunim me DSCP</p> <p>DMSHI</p>
---	---	--	--	---

<p>Akreditimi i DPM si organ inspektues në fushën e verifikimit /inspektimit të instrumenteve të peshimit jo-automatik, sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17020: 2012</p>	<p>audituese mbështetur në procedurën operacionale përkatëse për të verifikuar përbushjen e kërkesave të standardit ISO/IEC 17025:2017.</p> <p>5. Akreditimi i laboratorëve të matjeve elektrike, temperaturës dhe gjatësisë, sipas procedurave përkatëse, për kalibrimin e matësve të energjisë elektrike, multimetrit digjital, termometrave (të qelqit, PRT dhe digjitalë) në diapazonin -80 °C deri në 250 °C, si dhe të mikrometrave dhe kalibrave, nga një trupë akredituese e njohur formalisht në nivel ndërkombëtar.</p> <p>6. Kordinimi i vizitave vlerësuese për vlerësimin e kompetencës teknike në kuadër të akreditimit të laboratorëve/fushave matjeve elektrike, temperaturë dhe matje dimensionale.</p>	<p>Gjashhtëmujori i parë</p> <p>Gjashhtëmujori parë</p>	<p>Mbyllja me sukses i vlerësimit Marrja e certifikatës së akreditimit</p> <p>Mbyllja me sukses i vlerësimit Marrja e certifikatës së akreditimit</p>	<p>DSCP në bashkëpunim me DMSHI</p> <p>DMSHI dhe DSCP</p> <p>DSCP në bashkëpunim me DMSHI</p>
<p>1. Bashkëndimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit për të vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për akreditimin e DPM si organ inspektues sipas ISO/IEC 17020:2012.</p> <p>2. Organizimi dhe realizimi i vlerësimit nga grupi i vlerësimit të DPA</p> <p>3. Organizimi i trajnimeve të brendshme të personelit të metrologjisë ligjore (sektoreve të shërbimit) për vënien në zbatim të standardit</p>	<p>Dhënja e përgjigjeve në afatet e kërkuara</p> <p>Raporti i vlerësimit nga DPA Certifikata e akreditimit</p> <p>Dokumentimi i materialeve trajnuese dhe mirembajtja e regjistrimeve sipas kërkesave të SMC</p>	<p>Dhënja e përgjigjeve në afatet e kërkuara</p> <p>Raporti i vlerësimit nga DPA Certifikata e akreditimit</p> <p>Dokumentimi i materialeve trajnuese dhe mirembajtja e regjistrimeve sipas kërkesave të SMC</p>	<p>Dhënja e përgjigjeve në afatet e kërkuara</p> <p>Raporti i vlerësimit nga DPA Certifikata e akreditimit</p> <p>Dokumentimi i materialeve trajnuese dhe mirembajtja e regjistrimeve sipas kërkesave të SMC</p>	<p>DSCP në bashkëpunim me DML</p> <p>DSCP në bashkëpunim me DML</p> <p>DSCP në bashkëpunim me DML dhe DMSHI</p>

	<p>ISO 17020:2012 dhe dokumentacionit të SMC per metrologjine ligjore.</p> <p>4. Planifikimi, kryerja dhe dokumentimi i auditimeve/kontrolleve të brendëshme të Sistemit të Menaxhimit sipas programit vjetor të auditimeve për të verifikuar permbushjen e kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012.</p> <p>5. Hartimi /rishikimi i procedurave teknike të verifikimit të instrumenteve matëse objekt i kontrollit metrologjik ligjor me qëllim zgjerimin e fushëveprimit të sistemit të menaxhimit sipas ISO/IEC 17020:2012.</p>	<p>Gjatë vitit 2026</p> <p>Gjatë vitit 2026</p>	<p>Kryerja dhe dokumentimi i auditimeve sipas Programit vjetor të auditimeve të brendëshme të sistemit të menaxhimit të cilësisë, 2026.</p> <p>Procedurat e miratuara vihen në zbatim nga strukturat zbatuese</p>	<p>DSCP në bashkëpunim me DML dhe DMSHI</p> <p>DML në bashkëpunim me DSCP dhe DMSHI</p> <p>DMSHI dhe DML</p>
<p>Realizimi dhe përmirësimi i treguesve teknikë të shërbimeve metrologjike dhe atyre financiarë</p>	<p>1. Kryerja e kalibrimeve me qëllim sigurimin e gjurmueshmërisë metrologjike për operatorët ekonomike dhe industrinë; verifikimit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe interesit të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve.</p> <p>2. Autorizimi i dhe monitorimi i subjekteve juridikë, ose/dhe fizikë për kryerjen e veprimtarive në Metrologjinë Ligjore, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - verifikim i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara; - ekspertizë metrologjike; - riparim, verifikim i përkohshëm dhe vullosje. 	<p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë gjithë vitit Sipas afteve të përcaktuar në planin vjetor të monitorimit Sipas kërkesave të subjekteve, përgjatë vitit</p>	<p>Realizimi i 42 000 shërbimeve të verifikimit dhe kalibrimit dhe të ardhurave në masën e 73 milion lekë (pa TVSH).</p> <p>Raporte periodike (mujore, katërmujore dhe gjashtëmujore)</p> <p>Trajtimi i kërkesave të subjekteve për autorizim, shqyrtim i dokumentacionit përkatës, kryerja e vizitave vlerësuese dhe nxjerrja e vendimeve administrative për dhënie autorizimi</p>	<p>DMSHI dhe DML</p> <p>DPM</p>

	3. Mbyllja e bilancit për vitin 2025	Tremujori i parë	Dorëzimi i bilancit	DBNJSH
<p>Përfundimi i procesit të ngritjes së sistemit të menaxhimit sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17065:2012 për certifikimin e procesit të linjave të paketimit të produkteve të parapaketuara dhe aplikimi për akreditim</p>	<p>1. Përgatitja e dokumentacionit të sistemit të menaxhimit – integrimi i kërkesave të ISO/IEC 17065:2012 në dokumentacionin e sistemit të menaxhimit sipas ISO/IEC 17025:2017 dhe miratimi i tij.</p> <p>2. Hartimi dhe miratimi i skemës së certifikimit të procesit të paketimit të produkteve të parapaketuara në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17065 dhe Udhëzuesin e OIML G21 “Udhëzues që përcakton kërkesat për sistemin e certifikimit të produkteve të parapaketuara”</p> <p>3. Rishikimi i procedurave teknike të kontrollit sasior të parapaketimeve dhe procedurës për pajisjet laboratorike që përdoren për kontrollin sipas peshës dhe vëllimit</p> <p>4. Vënia në zbatim – miratimi dhe certifikimi i sistemit të kontrollit sasior të parapaketimeve</p> <p>5. Informim dhe ndërgjegjësim i prodhuesve dhe paketuesve të parapaketimeve mbi procesin e certifikimit dhe vendosjen e shenjës së konformitetit</p>	<p>Gjashtëmujori i parë</p> <p>Gjashtëmujori i parë</p> <p>Gjashtëmujori i parë</p> <p>Gjatë gjithë vitit</p> <p>Gjatë gjithë vitit</p>	<p>Dokumentacioni miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm</p> <p>Miratimi nga Drejtori i Përgjithshëm</p> <p>Miratimi i procedurave të rishikuara</p> <p>Rregjistrimet përkatëse vendosja e shenjës së konformitetit</p> <p>Aktivitete dhe materiale informuese</p>	<p>DSCP</p> <p>DSCP – Sektori i Parapaketimeve</p> <p>DSCP Sektori i Parapaketimeve</p> <p>DSCP/Sektori i Parapaketimeve</p> <p>DSCP/Sektori i Parapaketimeve</p>
<p>Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike laboratorike dhe përmirësimi i kushteve të punës</p>	<p>1. Përmirësimi i eficiencës së laboratorëve ekzistues për:</p> <p>i. Matjen të densitetit të trupave të ngurtë (gramarë) dhe të lengjeve</p> <p>ii. Kalibrimin e termometrave pa kontakt (me rrezatim)</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p>	<p>Konsulencë për hartimin e procedurave teknike dhe trajnimin e stafit teknik për vënien në punë të pajisjeve</p>	<p>DMSHI</p>

	<p>iii. Kalibrimin e pH-metrave dhe pajisjeve për matje të konduktivitetit</p> <p>iv. Verifikimin e radarëve të shpejtësisë</p> <p>v. Kalibrimin e instrumenteve për matje akustike (nivelelin e zhurmave)</p> <p>2. Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike nëpërmjet sigurimit të standardeve dhe pajisjeve matëse për fusha ekzistuese dhe të reja, përkatësisht:</p> <p>i. Zgjerimi i kapaciteteve matëse dhe kalibruese në fushën e masës, për kalibrimin e gramarëve me kapacitet mbi 100 kg.</p> <p>ii. Zgjerimi i diapazonit matës kalibrues për kalibrimin e instrumenteve matës të temperaturës (max 660 °C) duke përdorur metodën e krahasimit në ajër.</p> <p>iii. Forcimi i kapaciteteve laboratorike për kalibrimin e instrumenteve dhe pajisjeve në fushën e lagështisë, përmes zëvendësimit të dhomës klimatike të laboratorit me pajisje moderne dhe të standardizuar</p> <p>iv. Përmirësimi i kapaciteteve laboratorike për kalibrimin e analizuesve të alkolit në frymënxjerrje.</p> <p>v. Përmirësimi i kapaciteteve për kalibrimin e depozitave dhe rezervuarve të madhësive të ndryshme.</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Tremujori parë</p> <p>Tremujori parë</p> <p>Gjatë vitit 2026</p>	<p>laboratorike në në ambientet e laboratorëve të DPM.</p> <p>Hartimi i procedurave përkatëse dhe kalibrimi i etaloneve</p> <p>i. Realizimi i investimit, përfshi konsulentë/trajnim për vënien në punë. Në varësi të ecurisë së Projektit të Bankës Botërore</p> <p>ii. Realizimi i investimit përfshi konsulentë dhe/ose trajnim teknik. Hartimi i procedurës së kalibrimit</p> <p>iii. Realizimi i investimit për zëvendësimin e dhomës klimatike të laboratorit të lagështisë.</p> <p>iv. Realizimi i investimit për blerjen e bazës etalonuese, akreditimi i laboratorit</p> <p>v. Realizimi i investimit për blerjen e instrumentave referues për kalibrimin e depozitave rezervuarëve, drejt akreditimit të laboratorit</p>	<p>DMSHI dhe DML</p> <p>DPM, DMSHI</p> <p>DPM, DMSHI</p> <p>DPM, DMSHI</p> <p>DPM, DMSHI</p> <p>DPM, DMSHI</p>
--	---	--	--	--

<p>Zhvillimi, dhe përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të personelit</p>	<p>Ngritja e nivelit tekniko-profesional të punonjësve të DPM</p> <p>1. Pjesëmarrje në workshope, seminare dhe trajnime të organizuara me mbështetjen e buxhetit të shtetit, projekteve në zbatim për fushat teknike.</p> <p>2. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve të brendshme sipas nevojave lidhur me vlerësimin e pasigurisë së matjeve, menaxhimin e riskut, auditimet e brendshme, zbatimin në praktikë të procedurave teknike të kalibrimit dhe verifikimit të instrumenteve matëse të fushave të ndryshme, etj.</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Sipas programeve të vjetore trajnimeve</p>	<p>Organizimi i aktiviteteve dhe pjesëmarrja në trainime, pajisja me certifikatë</p> <p>Modulët përkatëse të trajnimeve – Raportet e pjesëmarrjes – certifikatat e trajnimeve</p>	<p>Punonjësit e DPM sipas fushave të aktivitetit</p> <p>Të gjithë drejtoritë e DPM</p>
<p>Dhënie kontributi për përafrimin e legjislacionit sipas Planit Kombëtar të Integritetit dhe planit të veprimit për adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 1</p>	<p>1. Kontribut për progresin periodik të monitorimit të planit kombëtar të Kapitullin 1 “Lëvizja e Lirë e Mallrave”/Standardet Evropiane /metrologjinë.</p> <p>2. Hartimi i raporteve periodike për planin e veprimit për adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 1.</p> <p>3. Hartimi i raporteve periodike për monitorimin e planit të veprimit për adresimin e neneve 34-36 të TFBE</p>	<p>Sipas kalendarit të monitorimit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p>	<p>Hartimi dhe dërgimi i materialeve në MEI brenda afateve që kërkohen raportet periodike</p> <p>Hartimi dhe dërgimi i materialeve në MEI brenda afateve që kërkohen raportet periodike</p> <p>Hartimi dhe dërgimi i materialeve në MEI brenda afateve që kërkohen raportet periodike</p>	<p>DPM</p> <p>DPM</p> <p>DPM</p>
<p>Zgjerimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe</p>	<p>1. Miratimi i projektligjit për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Metrit</p>	<p>Gjashëmujori parë</p> <p>Gjatë vitit</p>	<p>Ligji i miratuar nga Parlamenti</p> <p>Depozitimi i instrumentit të aderimit në BIPM</p>	<p>MEI, DPM</p> <p>MEI, MEPJ, DPM</p>

<p>evropiane metrologjisë,</p>	<p>2. Kordinimi me Byronë Ndërkombëtare të Pëshave dhe Masave për anëtarësimin me te drejta të plota</p> <p>3. Përmeshja e detyrimeve financiare për anëtarësimin në Konferencën Ndërkombëtare të Pëshave dhe Masave</p> <p>4. Pjesëmarrje në asambletë e përgjithshme dhe takimet vjetore të Komiteteve Teknike të Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare të metrologjisë: EURAMET, WELMEC, OIML dhe BIPM.</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit, sipas planifikimit</p>	<p>Pagesa e kutoos vjetore të anëtarësimit</p> <p>Realizimi i pjesëmarrjes në aktivitet, raporti përkatës</p>	<p>MEL, DPM</p> <p>DPM</p>
<p>Rritja ndërgjegjësimit publik për rolin dhe impaktin e metrologjisë në ekonomi</p>	<p>Organizimi i aktivitete promovuese dhe sensibilizuese për metrologjinë:</p> <p>i. Organizimi i Ditës Botërore e Metrologjisë më 20 Maj,</p> <p>ii. Botimi i gazetës periodike Metrologjia,</p> <p>iii. Organizimi i ditëve të hapura për universitetet, shkollat e mesme, etj</p> <p>iv. Takime informative me palët e interesuara, etj</p> <p>v. Përditësimi i informacionit në faqen zyrtare</p> <p>vi. Publikime në platformat sociale të institucionit.</p>	<p>Gjatë vitit</p> <p>2 herë në vit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p> <p>Gjatë vitit</p>	<p>- Aktivitetet ndërgjegjësues më 20 Maj 2026</p> <p>- Publikimi i gazetës Metrologjia</p> <p>- Materialet e publikuara</p> <p>- Minutat e takimeve, etj.</p> <p>- Materialet e publikuara</p> <p>- Materialet e publikuara</p>	<p>DPM</p>



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka